Vendim nr. 328, 14.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 14.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 20 (S) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES:	**STERJO PLEQI**
OBJEKTI:	**Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2026-371, datë 04.02.2026 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
BAZA LIGJORE:	**Nenet 42, pikat 1 dhe 2, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Paditësit në procesin gjyqësor objekt ankimi kushtetues individual kanë qenë pjesëtarë të një familjeje bujqësore, me kryefamiljar B.N., banorë të fshatit Voskopojë. Në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" (*Ligji për Tokën*), tashmë i shfuqizuar, me vendim të Komisionit të Tokës në Fshat, atyre u janë ndarë 4 ngastra toke bujqësore, të ndodhura në vendet e quajtura "Lapidari i vogël", me sipërfaqe 2.000 m^2, "Poshtanik", me sipërfaqe 1.000 m^2, "Përtej Baxhos", me sipërfaqe 500 m^2, dhe "Shën Harallami", me sipërfaqe 650 m^2. Për këto ngastra paditësit nuk janë pajisur me aktin e marrjes së tokës në pronësi (*AMTP*). Ndërkohë, sipas një deklarate pa datë, paditësi B.N. ka deklaruar se katër ngastrat i ka dorëzuar në favor të komunës Voskopojë. Në vijim, paditësit nuk janë pajisur me tokë tjetër bujqësore dhe as me AMTP-të për parcelat e sipërpërmendura.

2. Në datën 10.06.2005 paditësi B.N. u është drejtuar Komisionit të Tokës të Komunës Voskopojë dhe Komisionit të Tokës së Qarkut Korçë, duke kërkuar trajtimin me tokë bujqësore sipas ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" (*ligji nr. 8312/1998*). Me shkresën e datës 23.06.2005, çështja i është përcjellë për kompetencë Komisionit të Tokës të Komunës Voskopojë, duke iu referuar Ligjit për Tokën dhe VKM-së nr. 230, datë 22.07.1991 "Për krijimin e komisioneve të tokës", të ndryshuar (*VKM-ja nr. 230/1991*).

3. Pas një ankese të B.N., me shkresën e datës 06.10.2005, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ua ka përcjellë çështjen për kompetencë Komisionit të Tokës të Komunës Voskopojë dhe Këshillit të Qarkut Korçë, duke kërkuar verifikimin e pretendimeve të ankuesit dhe shqyrtimin e tyre. Në vijim, me shkresën e datës 12.10.2005, Këshilli i Qarkut Korçë ia ka përcjellë çështjen kryetarit të Komisionit të Tokës të Komunës Voskopojë, duke vlerësuar se ajo ishte në kompetencë të komisioneve të tokës në fshat dhe komunë. Me shkresën e datës 27.10.2005, komuna Voskopojë ka bërë të ditur se B.N. ishte informuar nga këto komisione se ngastrat që i ishin ndarë fillimisht në bazë të ligjit për tokën u ishin dhënë personave të tjerë, mbështetur në deklaratën e tij të refuzimit.

4. Në këto rrethana, paditësit i janë drejtuar gjykatës me padi kundër Komisionit të Tokës të Fshatit Voskopojë dhe Komisionit të Tokës të Komunës Voskopojë, duke kërkuar: (i) kundërshtimin, si të paligjshëm, të refuzimit për pajisjen me AMTP-në si subjekte të ligjit për tokën dhe për plotësimin me tokë bujqësore sipas normës mesatare për frymë; (ii) detyrimin e organeve të paditura për të nxjerrë aktin administrativ dhe nëpërmjet rishqyrtimit administrativ të

rivendosin të drejtën e tyre. Gjatë gjykimit, gjykata ka vendosur të thërrasë në gjykim, në cilësinë e personave të tretë, Këshillin e Qarkut Korçë dhe shtetasit Sterjo Pleqi (*kërkuesi*), Q.D., P.P. dhe V.B., duke vlerësuar se ata kishin interes për çështjen, për shkak të pretendimeve se disa nga sipërfaqet e tokës objekt gjykimi u ishin dhënë atyre në pronësi, sipas AMTP-ve përkatëse.

5. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 2137, datë 28.09.2007, ka vendosur: (i) pranimin e pjesshëm të padisë; (ii) detyrimin e Komisionit të Tokës të Fshatit Voskopojë të pajisë paditësit, me kryefamiljar B.N., me AMTP-në për ngastrën e pasqyruar në planvendosjen nr. 1 të aktit të ekspertimit, të ndodhur në vendin e quajtur "Lapidari vogël", tokë "arë", me sipërfaqe faktike 1.731 m^2; (iii) rrëzimin e padisë për pajisjen me AMTP për tri ngastrat e tjera të pasqyruara në planvendosjet nr. 2, 3 dhe 4 të aktit të ekspertimit, si dhe për plotësimin me tokë bujqësore sipas normës për frymë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim pala e paditur dhe personat e tretë, P.P. dhe kërkuesi.

6. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 70, datë 05.03.2008, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes, me arsyetimin se në dosjen gjyqësore nuk gjendej ndonjë vendimmarrje e organeve vendore të ndarjes së tokës, sipas parashikimeve të nenit 2, shkronja "c/1", të VKM-së nr. 291, datë 06.05.2005 (*VKM nr. 291/2005*). Mbi rekursin e paditësve dhe të personave të tretë, P.P. dhe kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2013-2359(549), datë 03.10.2013, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë.

7. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 309, datë 02.10.2014, ka shpallur moskompetencën e saj lëndore dhe ia ka dërguar çështjen Gjykatës Administrative të Apelit, si gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Në vijim, pas rigjykimit të çështjes, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 4281, datë 06.12.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Kundër vendimit të gjykatës së apelit, krahas Bashkisë Korçë, ka ushtruar rekurs edhe kërkuesi, duke kërkuar prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Ndër të tjera, ai ka kundërshtuar formimin e ndërgjyqësisë pasive, duke pretenduar se duhej të ishte thirrur në cilësinë e palës së paditur dhe se në proces duhej të merrnin pjesë edhe anëtarët e tjerë të familjes bujqësore.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2026-371, datë 04.02.2026, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin edhe të rekursit të kërkuesit, me

arsyetimin se rekurset nuk përmbanin argumente të qenësishme që të lidheshin me shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012*).

9. Në datën 23.06.2026, nëpërmjet shërbimit postar, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të mësipërm. Ankimi, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 09.07.2026. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

10. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë,* pasi gjykatat i kanë mohuar këtë të drejtë bashkëshortes së tij, M.P., duke mos e thirrur në gjykim, ndonëse çështja prekte edhe të drejtën e saj të pronësisë, në kushtet kur toka bujqësore i ishte ndarë familjes sipas numrit të anëtarëve të saj dhe bashkëshortja, sipas gjendjes familjare të vitit 1991, ka qenë një prej përfituesve, pavarësisht se AMTP-ja është lëshuar vetëm në emër të kërkuesit.

10.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit,* pasi gjykatat kanë disponuar për një sipërfaqe toke që është në pronësi të familjes së tij, ndërkohë që e kanë thirrur kërkuesin në cilësinë e personit të tretë dhe jo të palës së paditur, cilësi vetëm në të cilën ai do të kishte mundësi të debatonte për themelin dhe bazueshmërinë ligjore të padisë, si dhe të parashtronte prapësime për legjitimimin aktiv të paditësve dhe për legjitimimin pasiv.

10.3. *Parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën e pronës,* pasi Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, është shmangur nga praktika e saj për formimin e ndërgjyqësisë së detyrueshme pasive. Sipas vendimit nr. 00-2024-

4729(519), datë 03.12.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, bashkëpronarët që kanë cilësinë e bashkëndërgjyqësve të detyrueshëm pasivë duhet të marrin pjesë në gjykim si palë të paditura, qëndrim ky që duhej të zbatohej edhe në çështjen konkrete, ku bashkëshortja e kërkuesit, ndonëse bashkëpronare e tokës së përfituar nga familja bujqësore, nuk është thirrur në gjykim, ndërsa kërkuesi ka marrë pjesë vetëm në cilësinë e personit të tretë.

10.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë është mjaftuar me pasqyrimin e shkaqeve të rekursit, pa analizuar pretendimin se gjykatat kishin disponuar për pronën e familjes së kërkuesit pa u formuar drejt ndërgjyqësia e detyrueshme pasive, në kushtet kur ai ishte thirrur si person i tretë, ndërsa bashkëshortja nuk ishte thirrur në gjykim. Po ashtu, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje as pretendimit se gjykimi administrativ duhej të pushohej, pasi mosmarrëveshja për pronësinë e ngastrës duhej të zgjidhej në një proces gjyqësor civil, me padi rivendikimi.

III
Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

11. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të

gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, Kolegji mund të verifikojë një ose më shumë prej këtyre kritereve, pa qenë i detyruar të ndjekë një radhë të paracaktuar të analizës. Mospërmbushja e njërit prej tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Mbi këtë bazë, Kolegji do të ndalet në vijim në verifikimin e kritereve *ratione personae* dhe *ratione materiae*.

13. Në lidhje me kriterin *ratione personae*, Gjykata ka theksuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë material (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket aspektit material të këtij kriteri, Gjykata ka pohuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, duke treguar se në çfarë mënyre është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat e aktit të kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të justifikojë interesin e tij kushtetues, duke treguar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë sjellë pasoja vetjake, të drejtpërdrejta dhe reale në të drejtat e tij themelore.

14. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi ka marrë pjesë në procesin gjyqësor të kundërshtuar në cilësinë e personit të tretë dhe ka ushtruar mjetet e zakonshme të ankimit. Në këtë cilësi ai ka interes të drejtpërdrejtë për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese që pretendon se i janë cenuar nga procesi gjyqësor. Megjithatë, për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, Kolegji vëren se kërkuesi e mbështet atë në mosthirrjen në gjykim të bashkëshortes së tij, e cila, sipas tij, ka qenë anëtare e familjes bujqësore dhe përfituese e së drejtës së pronësisë mbi tokën objekt mosmarrëveshjeje. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se pretendimi lidhet, në thelb, me të drejtën e bashkëshortes për të marrë pjesë në një proces gjyqësor që, sipas kërkuesit, prek interesat e saj pasurorë. Nisur nga kjo, Kolegji vëren se kërkuesi nuk ka argumentuar se si mosthirrja e bashkëshortes ka cenuar drejtpërdrejt ushtrimin e së drejtës së tij të aksesit, përtej cenimit të pretenduar të të drejtave të bashkëshortes. Për rrjedhojë, për sa kohë pretendimi synon mbrojtjen e një të drejte kushtetuese të bashkëshortes, pra jo të drejta vetjake të kërkuesit, Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* për ngritjen e tij.

15. Në lidhje me kriterin *ratione materiae,* Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimeve të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën e pronës, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Këto pretendime, sipas natyrës dhe përmbajtjes së tyre, *prima facie* përfshihen në fushën e mbrojtjes kushtetuese, ndaj Kolegji do t'i analizojë ato në vijim.

16. Për sa i përket pretendimit për *cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën e pronës,* kërkuesi ka argumentuar se Gjykata e Lartë është shmangur nga praktika e saj për formimin e ndërgjyqësisë së detyrueshme pasive, konkretisht nga vendimi nr. 00-2024-4729 (519), datë 03.12.2024 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit bashkëpronarët duhet të marrin pjesë në gjykim si palë të paditura dhe jo si persona të tretë.

17. Gjykata ka vlerësuar se parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndër të tjera, garantimin e besimit të individit te shteti, institucionet e tij dhe aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me pretendimet për cenimin e këtij parimi për shkak të mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme, Gjykata ka theksuar se vlerësimi kushtetues bëhet rast pas rasti, duke mbajtur parasysh rrethanat dhe veçoritë e secilës çështje. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në çështje të ngjashme nuk mjafton, në vetvete, për të mbështetur *a priori* pretendimet e individit, për sa kohë çdo çështje ka individualitetin e saj, në varësi të rrethanave faktike, provave dhe kuadrit ligjor të zbatueshëm (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi nr. 00-2024-4729 (519), datë 03.12.2024 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, të cilit i referohet kërkuesi, është dhënë në një mosmarrëveshje administrative që kishte për objekt cenimin e titullit ekzistues të pronësisë së përfituar në bazë të AMTP-së. Në atë vendim, në zbatim edhe të vendimit njësues nr. 00-2024-5505(210), datë 14.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, është mbajtur qëndrimi se në gjykimet që synojnë zhbërjen e titullit të pronësisë së fituar nga familja bujqësore, të gjithë bashkëpronarët përfitues duhet të marrin pjesë në gjykim në cilësinë e palëve të paditura, pasi vendimi gjyqësor prek drejtpërdrejt të drejtat e tyre.

19. Ndërkohë, në çështjen në shqyrtim, Kolegji vëren se padia është ngritur nga individë kundër organeve publike dhe ka pasur për objekt kundërshtimin e refuzimit për pajisjen me AMTP

dhe detyrimin e këtyre organeve për nxjerrjen e aktit administrativ përkatës. Në këtë proces gjykatat e faktit kanë shqyrtuar edhe pretendimet e kërkuesit për pronësinë mbi ngastrën objekt mosmarrëveshjeje, duke arritur në përfundimin se ajo nuk përfshihej në titullin e tij të pronësisë. Edhe pse gjykatat kanë vlerësuar titullin e pronësisë së kërkuesit për të përcaktuar nëse ngastra objekt gjykimi ishte sipërfaqe toke e lirë, ky vlerësim është bërë në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes administrative, pa u disponuar për pavlefshmërinë e AMTP-së së tij, fshirjen e regjistrimit të pasurisë ose detyrimin për lirimin dhe dorëzimin e ngastrës. Megjithatë, mungesa e një disponimi të tillë nuk përjashton mundësinë që pajisja e paditësve me AMTP të sjellë pasoja në marrëdhëniet e pronësisë ose regjistrimit të pasurisë, për sa kohë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se ata mund të ndjekin më pas mjetet juridike për kundërshtimin e regjistrimit ekzistues. Këto pasoja të mundshme, sidoqoftë, duhen dalluar nga disponimi i drejtpërdrejtë gjyqësor për cenimin ose zhbërjen e titullit ekzistues të pronësisë.

20. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se, ndryshe nga çështja e referuar prej kërkuesit, gjykimi konkret nuk ka pasur për objekt cenimin ose zhbërjen e titullit ekzistues të pronësisë së anëtarëve të familjes së tij, por zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje administrative lidhur me detyrimin e organit publik për nxjerrjen e AMTP-së. Dallimet në objektin e padisë, natyrën e mosmarrëveshjes dhe efektet e disponimeve gjyqësore përbëjnë elemente objektive që justifikojnë trajtimin e ndryshëm të çështjes së ndërgjyqësisë pasive. Në këtë kuptim, qëndrimi njësues i referuar nga kërkuesi, i cili lidhet me gjykimet për ligjshmërinë e titujve ekzistues të pronësisë, nuk rezulton të jetë i zbatueshëm në të njëjtën mënyrë në çështjen konkrete. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka evidentuar një shmangie të pajustifikuar nga praktika gjyqësore, të tillë që të përbëjë cenim të parimit të sigurisë juridike, ndaj ky pretendim është haptazi i pabazuar.

21. Për pretendimin e cenimit të *parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, kërkuesi ka argumentuar se thirrja e tij në procesin gjyqësor në cilësinë e personit të tretë dhe jo të palës së paditur i ka mohuar mundësinë për të debatuar në mënyrë të plotë mbi bazueshmërinë faktike dhe ligjore të padisë, si dhe për të parashtruar prapësime lidhur me legjitimimin aktiv dhe pasiv.

22. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se formimi i parregullt i ndërgjyqësisë mund të përbëjë cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, veçanërisht në drejtim të parimeve të kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 14, datë 15.04.2003; nr. 13, datë*

18.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata ka theksuar se pretendimi për formimin e parregullt të ndërgjyqësisë duhet të vlerësohet në raport me lidhjen e drejtpërdrejtë të shkeljes së pretenduar me kërkuesin, si dhe me ndikimin që ajo mund të ketë pasur në zhvillimin dhe rezultatin e procesit gjyqësor (*shih vendimin nr. 26, datë 09.04.2024; nr. 34, datë 29.05.2015; nr. 14, datë 15.04.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga paditësit kundër organeve publike, me objekt kundërshtimin e refuzimit për pajisjen me AMTP dhe detyrimin e organit kompetent për nxjerrjen e këtij akti administrativ. Në përfundim të gjykimit është vendosur detyrimi i Komisionit të Tokës të Fshatit Voskopojë për pajisjen e paditësve, me kryefamiljar B.N., me AMTP-në për ngastrën e ndodhur në vendin e quajtur "Lapidari i vogël", me sipërfaqe 1.731 m^2. Kërkuesi ka pretenduar se kjo ngastër përfshihej në të drejtën e pronësisë së fituar prej tij me AMTP-në përkatëse, ndaj duhej të ishte thirrur në gjykim në cilësinë e palës së paditur dhe jo të personit të tretë.

24. Kolegji vëren se, sipas nenit 195 të Kodit të Procedurës Civile, personi i tretë ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet procedurale që u lejohen palëve, me përjashtim të atyre që përbëjnë disponim të objektit të padisë. Në rastin konkret, pavarësisht cilësisë së tij procedurale, kërkuesi ka marrë pjesë në procesin gjyqësor dhe ka parashtruar kundërshtimet e tij lidhur me titullin e pronësisë dhe shtrirjen e tij mbi ngastrën objekt mosmarrëveshjeje. Këto pretendime janë shqyrtuar nga gjykatat e faktit, të cilat kanë vlerësuar dokumentacionin kadastral dhe aktet e ekspertimit të administruara në gjykim, duke arritur në përfundimin se AMTP-ja e kërkuesit nuk përfshinte sipërfaqen e tokës për të cilën ishte vendosur pajisja e paditësve me AMTP. Nga ana tjetër, gjykatat nuk kanë disponuar për pavlefshmërinë e titullit të pronësisë së kërkuesit, fshirjen e regjistrimit të pasurisë ose detyrimin e tij për lirimin dhe dorëzimin e ngastrës.

25. Në këto rrethana, duke mbajtur parasysh objektin e padisë, përmbajtjen e disponimeve gjyqësore, të drejtat procedurale që ligji i njeh personit të tretë dhe pjesëmarrjen konkrete të kërkuesit në proces, Kolegji vlerëson se cilësimi i tij procedural si person i tretë nuk rezulton ta ketë penguar në ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes. Në veçanti, kërkuesi nuk ka evidentuar se cilat prapësime konkrete për themelin e mosmarrëveshjes ose legjitimimin e palëve nuk ka mundur të parashtrojë për shkak të këtij cilësimi, ndërkohë që pretendimet e tij lidhur me pronësinë mbi ngastrën janë marrë në shqyrtim nga gjykatat e faktit. Për rrjedhojë, në mungesë të

argumentimit të një kufizimi konkret të të drejtave të tij procedurale dhe të ndikimit që ky kufizim mund të ketë pasur në proces, Kolegji çmon se pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është haptazi i pabazuar.

26. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* duke argumentuar se Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje shkaqeve të ngritura në rekurs, veçanërisht atyre që lidhen me formimin e ndërgjyqësisë së detyrueshme pasive, pozitën e tij procedurale dhe nevojën për zgjidhjen e konfliktit të pronësisë në një proces gjyqësor civil.

27. Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore është element thelbësor i një vendimi të drejtë, pasi u mundëson palëve të kuptojnë se pretendimet e tyre janë dëgjuar dhe të ushtrojnë në mënyrë efektive të drejtën e ankimit (*shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 12, datë 19.03.2015; nr. 33, datë 08.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka vlerësuar se vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, për sa kohë në pjesën hyrëse të tyre pasqyrohen shkaqet e rekursit dhe arsyetimi shpreh, në thelb, shkaqet e mospranimit. Detyrimi për arsyetimin e vendimit nuk nënkupton dhënien e një përgjigjeje të detajuar për çdo argument të palëve. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, duhet t'i marrë ato në shqyrtim dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 2, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata ka theksuar vazhdimisht se vlerësimi i fakteve dhe provave, si dhe interpretimi e zbatimi i ligjit, janë, si rregull, kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Kontrolli kushtetues nuk synon rivlerësimin e provave ose zëvendësimin e përfundimeve të këtyre gjykatave, por verifikimin nëse procesi gjyqësor ka respektuar garancitë kushtetuese dhe nëse arsyetimi i vendimeve gjyqësore është i qartë, koherent dhe jo arbitrar (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 7, datë 07.02.2017; nr. 13, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Kolegji vëren se padia e paraqitur nga paditësit ka pasur për objekt kundërshtimin e refuzimit të organeve publike për pajisjen me AMTP-të përkatëse dhe plotësimin me tokë bujqësore sipas normës për frymë, si dhe detyrimin e këtyre organeve për nxjerrjen e akteve administrative. Gjykata e shkallës së parë e ka pranuar pjesërisht padinë, duke

vendosur pajisjen e paditësve, me kryefamiljar B.N., me AMTP-në për ngastrën e ndodhur në vendin e quajtur "Lapidari i vogël", me sipërfaqe faktike 1.731 m^2. Ky përfundim është mbështetur në aktin e ekspertimit topografik dhe në dokumentacionin e përcjellë nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, mbi bazën e të cilave gjykata ka vlerësuar se ngastra në fjalë nuk i ishte dhënë në pronësi ndonjë personi tjetër dhe se ajo nuk përfshihej në titullin e pronësisë së kërkuesit. Në veçanti, gjykata ka arsyetuar se regjistrimi i pasurisë në favor të P.P., i cili e kishte fituar atë me kontratë shitblerjeje nga kërkuesi, ishte rezultat i një pasaktësie në pasqyrimin hartografik të pronës, ndërsa AMTP-ja e kërkuesit nuk i korrespondonte sipërfaqes së tokës së ndodhur në vendin e quajtur "Lapidari i vogël". Sipas gjykatës, pajisja e paditësve me AMTP-në për këtë ngastër do t'u krijonte atyre mundësinë për të ndjekur më pas mjetet juridike për regjistrimin e pasurisë dhe kundërshtimin e regjistrimit ekzistues. Për tri ngastrat e tjera, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se ato ishin regjistruar në favor të personave të tjerë në bazë të AMTP-ve ose të vendimeve të organeve të kthimit të pronave, ndaj paditësit nuk mund të pajiseshin me AMTP-të përkatëse. Po kështu, ajo ka rrëzuar kërkimin për plotësimin me tokë bujqësore sipas normës për frymë, duke vlerësuar se nuk ishin përmbushur kushtet ligjore dhe provuese për përfitimin e saj.

30. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit, pasi ka shqyrtuar pretendimet e palëve, ka vlerësuar se nuk ishte provuar ndjekja e procedurës formale të refuzimit të tokës nga paditësi B.N., sipas VKM-së nr. 231, datë 19.05.1993 "Për tokat që refuzohen të merren në pronësi ose në përdorim dhe zgjidhjen e kërkesave të shtetasve për lënien e tokës". Po kështu, në lidhje me pretendimin e kërkuesit për pronësinë mbi ngastrën në vendin e quajtur "Lapidari i vogël", gjykata e apelit i është referuar aktit të ekspertimit dhe shtesës së tij, si dhe dokumentacionit kadastral të administruar në gjykim. Nga krahasimi i këtyre akteve me AMTP-në e kërkuesit, gjykata ka arritur në përfundimin se sipërfaqja e tokës e përfituar prej tij nuk përputhej me ngastrën e pretenduar nga paditësit. Në veçanti, duke iu referuar kufizimeve dhe vendndodhjes së pasurive sipas dokumentacionit kadastral dhe hartave përkatëse, gjykata ka vlerësuar se ngastra prej 1.731 m^2, e ndodhur në vendin e quajtur "Lapidari i vogël", nuk mbivendosej me sipërfaqen e përfituar nga kërkuesi në bazë të AMTP-së. Në këto rrethana, gjykata e apelit ka çmuar se ngastra objekt gjykimi nuk rezultonte t'i ishte dhënë në pronësi ndonjë personi tjetër dhe se gjykata e shkallës së parë kishte vendosur drejt detyrimin e organit publik për pajisjen e paditësve me AMTP-në përkatëse.

31. Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, duke vlerësuar se shkaqet e parashtruara nuk përfshiheshin në ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Sipas Gjykatës së Lartë, rekursi nuk përmbante argumente të qenësishme që të justifikonin shqyrtimin e çështjes sipas kritereve ligjore dhe nuk evidentohej ndonjë çështje ligjore që duhej të trajtohej kryesisht prej saj.

32. Në vlerësim të sa më sipër, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë, në vendimin e kundërshtuar, ka pasqyruar shkaqet e ngritura në rekursin e kërkuesit, përfshirë pretendimet për formimin e parregullt të ndërgjyqësisë pasive, për shkak të thirrjes së tij në cilësinë e personit të tretë dhe të mosthirrjes së anëtarëve të tjerë të familjes bujqësore, si dhe për nevojën e zgjidhjes së konfliktit të pronësisë në një proces gjyqësor civil. Në vijim, ajo gjykatë ka arsyetuar në lidhje me kufijtë e juridiksionit të saj rishikues dhe kriteret ligjore të pranimit të rekursit, duke vlerësuar se shkaqet e parashtruara nuk përmbushnin kërkesat e nenit 58 të ligjit nr. 49/2012 dhe se nuk kishte vend për shqyrtimin kryesisht të ndonjë çështjeje ligjore. Ndonëse Gjykata e Lartë nuk ka zhvilluar një analizë të veçantë për secilin prej pretendimeve procedurale të kërkuesit, mjaftueshmëria e arsyetimit të saj duhet vlerësuar në raport me natyrën e këtyre pretendimeve, përmbajtjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrethanat konkrete të çështjes.

33. Në këtë drejtim, Kolegji konstaton se pretendimet e kërkuesit lidhur me pronësinë mbi ngastrën objekt mosmarrëveshjeje janë shqyrtuar nga gjykatat e faktit, të cilat kanë dhënë përgjigje të arsyetuara për to. Në veçanti, përfundimi se ngastra e ndodhur në vendin e quajtur "Lapidari i Vogël" nuk përfshihej në titullin e pronësisë së kërkuesit është mbështetur në dokumentacionin kadastral dhe në aktet e ekspertimit të administruara gjatë gjykimit. Vendimet e këtyre gjykatave pasqyrojnë rrethanat e çështjes, pretendimet e palëve, provat e administruara, faktet e konsideruara të provuara dhe bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur zgjidhja e mosmarrëveshjes.

34. Për sa u përket pretendimeve për formimin e parregullt të ndërgjyqësisë dhe nevojën e zgjidhjes së konfliktit të pronësisë në një proces gjyqësor civil, Kolegji vëren se procesi i zhvilluar ka pasur për objekt kundërshtimin e refuzimit të organit publik për pajisjen me AMTP dhe detyrimin e tij për nxjerrjen e aktit përkatës administrativ. Gjykatat e faktit kanë vlerësuar dokumentacionin e pronësisë së kërkuesit në funksion të zgjidhjes së kësaj mosmarrëveshjeje, pa disponuar drejtpërdrejt për pavlefshmërinë e titullit të tij të pronësisë, fshirjen e regjistrimit të pasurisë ose detyrimin për lirimin dhe dorëzimin e saj. Nga ana tjetër, kërkuesi ka marrë pjesë në

procesin gjyqësor, ka parashtruar kundërshtimet e tij lidhur me pronësinë mbi ngastrën dhe ka ushtruar mjetet e ankimit. Në këtë kuptim, pretendimet e tij për ndërgjyqësinë dhe natyrën e mosmarrëveshjes duhet të vlerësohen në lidhje me objektin e padisë, efektet e vendimeve gjyqësore dhe ndikimin konkret të cilësisë së tij procedurale në ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes.

35. Në këto rrethana, Kolegji çmon se, ndonëse arsyetimi i Gjykatës së Lartë është i kufizuar dhe nuk përmban një përgjigje të veçantë për secilin shkak të rekursit, duke mbajtur parasysh objektin e mosmarrëveshjes, përmbajtjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe mundësinë e kërkuesit për të parashtruar e mbrojtur pretendimet e tij gjatë procesit, nuk rezulton që shkaqet e ngritura në rekurs të kenë evidentuar një cenim konkret të të drejtave të tij procedurale, i cili, për nga natyra dhe rëndësia, të kërkonte domosdoshmërisht një arsyetim më të zgjeruar nga Gjykata e Lartë. Duke i vlerësuar vendimet gjyqësore në tërësinë e tyre, nuk evidentohen mangësi thelbësore në arsyetim, kundërthënie, alogjizëm ose elemente arbitrariteti të një natyre dhe shkalle të tillë që të ngrenë një çështje kushtetuese. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

36. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “b” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.